



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1346/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e Shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbareme të kreditorit N.T.P “...”, me adresë rr, “...” nr...., Prishtinë, me nr., me pronar A.... .., kundër debitorit Korporata Energjetike e Kosovës, me adresë rr. “.....” nr.... Prishtinë, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.545/20 të datës 12.01.2021, jashtë seancës me datë 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.T.P “...”, me adresë rr, “...” nr...., Prishtinë, me nr., me pronar A.... .., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.545/20 të datës 12.01.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin e atakuar, PPP.nr.545/20,të datës 12.01.2021, ka vendosur si në vijim: “I. Aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me adresë rr. “Nënë Tereza” nr.36, Prishtinë. II. Shfuqizohet urdhri i Përmbaremit Privat Fadil. I. Hoxha P.nr.578/2014 i dt. 24.11.2014, mbi caktimin e përmbaremit. III. Përfundohet procedura përmbareme P.nr.578/2014 dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra në çështjen përmbareme.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbareme, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i atakuar dhe të aprovohet urdhri i përmbaremit Privat Fadil. I. Hoxha P.nr.578/2014 i dt. 24.11.2014, mbi caktimin e përmbaremit.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, me propozim që gjykata ta refuzoj ankesën e kreditorit dhe këtë çështje ta shpall të përfunduar në kuptim të dispozitave të LPP –së, dhe aktvendimin e atakuar PPP.nr.545/20 dt. 12.01.2021 ta vërtetoj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave nr..... e dt. 08.06.2010, e dt. 10.06.2010.... e dt. 18.01.2011 dhe fatura nr.... dt. 28.01.2011, me të cilat ka kërkuar që të detyrohet debitori të paguaj borxhin në shumë prej 12.108.75, brenda afatit prej 7 ditësh, me kamatë 8%, duke filluar nga dt. 24.11.2014 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore i ka kërkuar.

Përmbaruesi Privat Fadil. I. Hoxha, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.578/2014, të datës 24.11.2014, e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datën 09.12.2014 ka paraqitur prapësim duke theksuar se kërkesa është parashkuar sipas nenit 357 par 1 të LMD –së, me propozim që të abrogohet urdhri përmbarimor i përmbaruesit privat Fadil Hoxha P.nr.578/14 dt. 24.11.2014, të aprovohet kundërshtimi i debitorit dhe të refuzohet propozimi për përmbarim për shkak të parashkrimit të kërkesës. Përmbaruesi Privat, ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 09.12.2014, duke kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, me arsyetimin se prej paraqitjes së faturave duplikat nuk kanë kaluar 3 vite, duke i propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë Aktvendimin PPP.nr.545/20 të dt. 12.01.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht sikur në arsyetim të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit ndaj këtij aktvendimi, ka nxjerrë aktvendimin Ac.nr.670/19 të dt.28.4.2020, me të cilin e ka aprovuar ankesën e kreditorit si të bazuar, ka prishë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.561/20 të dt. 29.06.2018, dhe çështjen i ka kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedure duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, PPP.nr.545/20, të datës 12.01.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht sikur në arsyetim të këtij aktvendimi

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pretendimin e debitorit për parashkrimin e borxhit nga neni 374 të LMD –së (Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve Gazeta Zyrtare e RSFJ - së), ose neni 355 Ligjit nr. 04/L-077 të LMD –së, gjykata e ka vlerësuar si të bazuar. Ka shtuar se meqenëse kreditori me propozimin për përmbartim të parashtruar me dt. 24.11.2014, ka kërkuar borxhin për faturat e datave 08.06.2010, 10.06.2010, 18.01.2011 dhe 28.01.2011, pas vlerësimit të afateve të parashkrimit lidhur me këto fatura, ka gjetur se ka arritur parashkrimi i kërkesës, për arsye se borxhi për faturën e fundit është i datës 28.01.2011, ndërsa propozimin për përmbartim të përmbartuesit privat është parashtruar me dt. 24.11.2014, respektivisht pasi ka kaluar afati i parashkrimit me shumë se 3 vite. Gjykata vlerësoj se dokumentet e besueshme në bazë të cilave kreditori ka kërkuar përmbartimit nuk i plotësojnë kushtet për lejimin e përmbartimit, pasi që të njëjtat kanë arritur afatin e parashkrimit. Ka shtuar se duke iu përmbartur sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, përfundoj procedurën duke u bazuar në nenin 12 par 4 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale–Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me faturat me nr.... e dt. 08.06.2010, e dt. 10.06.2010.... e dt.18.01.2011 dhe fatura nr. e dt. 28.01.2011, mirëpo të njëjtat në rastin konkret sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mbështetje të nenit 374 të LMD –së (Gazeta zyrtare RFJ – së viti 1978) dhe neni 355, paragrafi 1, dhe 2 të LMD-së i riu (Ligji 04/L-077), kanë arritur afatin e parashkrimit.

Me nenin 374 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta zyrtare e RSFJ- 30 mars viti 1978) i cili ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit detyrimor në rastin konkret është paraparë se: *“Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet, ndërsa par 2 i të njëjtin nen parasheh se: Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer.*

Në mënyrë të njëjtë ka paraparë edhe Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve i cili ka hyrë në fuqi me 20.12.2012, me nenin 355 të tij ku parashihet se: *Kërkesat reciproke nga kontratat*

komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”

Me dispozitat e lartcekura, është paraparë që afati i parashkrimit të kërkesave reciproke nga kontratat komerciale parashkruhen për 3 vite dhe që afati i parashkrimit fillon të rrjedh për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, ndërsa nga shkresat e lëndës vërtetohet se fatura e fundit për të cilin kreditori kërkon përmbarimin është e dt.28.01.2011, kurse propozimi për përmbarim është iniciuar me dt. 24.11.2014, me ç rast rezulton që i njëjti është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor prej 3 vite brenda të cilit kreditori ka të drejtë që të kërkoj borxhin, nga ku rezulton që në mënyrë të drejtë dhe në harmoni të plotë me dispozita ligjore vlerësoj edhe gjykata e shkallës së parë.

Në këtë kontekst, Dhoma e shkallës së dytë pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, respektivisht lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë rrjedhjen e afatit të parashkrimit është dashur ta llogarisë nga dt. 22.10.2012, pasi që atëherë debitori ka pranuar duplikatin e faturave nga kreditori dhe ka pasur pohim të borxhit nga ana e tij, nuk i ka pranuar si të bazuara, e po ashtu duke u mbështetur edhe në nenin 387 të LMD –së (viti 1978) i cili ka përcaktuar se: *Parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin. Pohimi i borxhit mund të blihet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyr indirekte, siç janë dhënia e kisteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit.* Si dhe neni 388 përcakton se: *“Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”,* nga ku rezulton që shkaqet të cilat i ka potencuar kreditori në ankesë nuk hynë në shkaqet e ndërprerjes e parashkrimit dhe po ashtu të njëjtat as nuk janë pranimit të tërthortë i borxhit siç kreditori pretendon, andaj edhe në këtë drejtim gjykata ankimore e pranon në tërësi si të bazuar qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit rezultojnë si të pathemelta.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1346/22 me datë 05.09.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha